



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 37/3 Prot.

Tiranë, më 07/12/2011

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin “Union Bank” Tiranë.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “Union Bank” Tiranë.

KONSTATOVA

Më datë 12/09/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, “Union Bank” Tiranë, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij ekonomiko-financiar, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë punonjës etj.).
- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi relacionin e grupit të kontrollit administrativ, procesverbalin e shkeljeve të konstatuara gjatë kontrollit administrativ të ushtruar, si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi "Union Bank" Tiranë" mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit me kamera CCTV, jashtë ambienteve të kontrolluesit, duke monitoruar dhe pjesën e trotuarit dhe rrugës ngjitur me godinën e tij, për kalimtarë të rastësishëm të cilët nuk janë subjekt i qëllimit të këtij përpunimi.

Mbledhja e të dhënave personale (imazhet) të kalimtarëve konsiderohet e tepërt lidhur me qëllimin për të cilin kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit CCTV, duke qenë kështu në kundërshtim me:

- Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" nenin 5 pika 1 gërma "c" *..të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim*";
- Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme";
- Rregulloren "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare" (neni 10 pika "a"), miratuar me vendimin nr. 04 datë 19/01/2011 të Këshillit Mbikqyrës së Bankës së Shqipërisë.

2. Kontrolluesi "Union Bank" Tiranë" mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit me kamera CCTV në ambientet dhe godinat ku ushtron veprimtarinë bankare dhe financiare dhe nuk ka të vendosura në këto ambiente, tabela informuese për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale nëpërmjet sistemit me kamera CCTV, duke qenë kështu në kundërshtim me:

- Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" nenin 18 "Detyrimi për informim";
- Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme".

3. Kontrolluesi "Union Bank" Tiranë mban në ambientet e tij në arshivë fizike, dosjet me të dhëna personale të ish punonjësve të tij, (subjekte të të dhënave personale), të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë kontrollues.

Mbajtja e dosjeve të ish punonjësve me të dhëna personale, tej qëllimit për të cilin ato janë mbledhur, konsiderohet shkelje e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", nenet 5 pika 1/d dhe 27/4;

- (neni 5 pika "d")... "në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej";
- (neni 27/4)... "dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar";
- Udhëzimit nr.11 datë 08/09/2011 "Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat" të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pika 5 "Respektimi i parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale", 5/3 "b"... të jenë të mjaftueshme, të sakta, të mbahen në atë formë që të lejojnë identifikimin e subjektit të

të dhënave për një kohë aq sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.

4. Kontrolluesi “*Union Bank*” Tiranë në marrëdhëniet dhe kontratat që ka lidhur me palë të treta (operatorë të ndryshëm), gjatë ushtrimit të veprimtarisë bankare dhe financiare, nuk ka të përcaktuar, në mënyrë të qartë dhe të shprehur detyrimet lidhur me mbrojtjen, konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale që përcaktohen në nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”.

- *”Kontrolluesi merr masa të veçanta sigurie... udhëzon operatorët pa përjashtim për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave , përfshirë dhe rregullat për sigurinë e të dhënave”.*

- *“Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj”.*

5. Kontrolluesi “*Union Bank*” në deklaratimet e bëra në “Formularin e Njoftimit” pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk ka deklaruar dhe plotësuar disa nga rubrikat e këtij formulari, të cilat lidhen me kategorinë e subjekteve të të dhënave personale, mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale të tilla si:

- Në formularin e njoftimit nuk është deklaruar mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale në mënyrë “manuale” (rubrika 3.1 e formularit).

- Nuk është deklaruar mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave personale “*nëpunës*”, “*aksionerë*” (rubrika 5 e formularit)

- Nuk ka deklaruar të gjitha kategoritë e të dhënave personale që përpunohen të tilla si të dhëna për shëndetin, gjendjen penale, numrin e sigurimeve shoqërore, formimi, diplomat etj. (rubrika 6 e formularit)

- Nuk ka deklaruar në formularin e njoftimit përpunimin e të dhënave sensitive për subjektet e të dhënave të tilla si, të dhëna për shëndetin, gjendjen penale (rubrika 7.2 e formularit).

- Në formularin e njoftimit është deklaruar që ka një dokument të qartë për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga kontrolli nuk u konstatua një dokument i tillë (rubrika 10 e formularit).

Mosdeklarimi korrekt në formularin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave personale, nga ana e kontrolluesit “*Union Bank*”, konsiderohet shkelje e nenit 21 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... “*Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë*”.

REKOMANDOJ

- 1) Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nenin 5 pika 1 gërma “c”, udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”, rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare” (neni 10 pika “a”), kontrolluesi “Union Bank” të mos mbledhë dhe përpunojë të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të kamerave CCTV, tej fasadës të godinave ku ushtron veprimtarinë bankare dhe financiare;
- 2) Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” nenin 18, udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”, kontrolluesi “Union Bank” të vendosë tabela informuese (*sipas modelit tip të miratuar me urdhrin nr. 33 datë 27/06/2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*) për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale nëpërmjet sistemit me kamera CCTV, në të gjitha ambientet dhe godinat ku ushtron veprimtarinë bankare dhe financiare;
- 3) Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” neneve 5 pika 1/d, 27/4 e tij dhe udhëzimit nr. 11 datë 08/09/2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, kontrolluesi “Union Bank” të shkatërrojë të dhënat personale të ish punonjësve (subjekte të të dhënave personale), të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë kontrollues.
- 4) Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Union Bank” të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të shprehur detyrimet lidhur me mbrojtjen, kofidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale, në kontratat që do të lidhe me palë të treta;
- 5) Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” neni 21 të plotësojë formularin e njoftimit pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke njoftuar:
 - mbledhjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale në rrugë “manuale”, për subjektet të ndryshëm të të dhënave personale.
 - mbledhjen, përpunimin, ruajtjen e të dhënave personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave personale “nëpunës”, “aksionerë”.
 - kategoritë e të dhënave personale që përpunohen të tilla si të dhëna për shëndetin, gjendjen penale dhe numrin e sigurimeve shoqërore.

- mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave sensitive për subjektet e të dhënave (të dhëna për shëndetin, gjendjen penale).

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

FLORA CABEJ (POGAÇE)

